



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (1) (Anglisht)

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë
Viti / Semestri : Viti I, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor, Gjuhë angleze
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndor: Kursi synon: Të thellojë njohuritë e studentëve në gjuhën angleze, me theks të veçantë në fjalor dhe gramatikë; Të zhvillojë të katër aftësitë gjuhësore: të folurit, dëgjimin, leximin dhe të shkruarit; Të forcojë vetëbesimin e studentëve në komunikimin e përditshëm në gjuhën angleze; Të nxisë njohjen dhe përdorimin e gjuhës së përditshme dhe shkrimit në një nivel paramesatar, në kontekstin kulturor anglishtfolës.

Objektivat specifike lëndorë:

1. Të njohin dhe të përdorin frazeologji, folje frazale dhe shprehje kontekstuale të kulturës anglishtfolëse;
2. Të analizojnë dhe kuptojnë strukturën e dokumenteve zyrtare dhe jozyrtare në gjuhën angleze;
3. Të zhvillojnë aftësinë për të krijuar histori ose tekste duke përdorur fjalor të kontekstualizuar;
4. Të inkurajohen për të vazhduar mësimin në mënyrë të pavarur, në përputhje me interesat e tyre, me ndihmën e materialeve shtesë.

Rezultatet e pritshme:

1. Në përfundim të kursit, studentët duhet të jenë të aftë:
2. Të pyesin dhe të përgjigjen në anglisht për tema të jetës së përditshme;
3. Të komunikojnë pa vështirësi me folës të tjerë të anglishtes;
4. Të diskutojnë për tema të larmishme në klasë ose të propozuara prej tyre;
5. Të përdorin anglishten në dokumente të ndryshme, mesazhe elektronike dhe tekste tregimtare;
6. Të shkruajnë histori duke përdorur fjalorin e përvetësuar;
7. Të kuptojnë dhe të përpunojnë një tekst të lexuar;